

Akt Themelimi

I shoqerise tregtare "ITALFIL" SH.P.K.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit", te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi, une ortaku Znj. Daniela Aliaj, me nr. ID 175502018L krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ITALFIL" SH.P.K. me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Sot me date 01.11.2018, formohet shoqeria tregtare private e quajtur "ITALFIL" SH.P.K. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Ne Shkozë, Durrës, e ndodhur ne zona kadastrale nr. 8515, pasuria me numer 5/397.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve te saj.

Objektivi i Veprimtarise

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Import-eksport i mallrave të ndryshëm industrial, tregtim me shumice dhe pakice të materialeve te para, aksesoreve te ndryshem, te fijeve per qepje per te gjitha llojet e rrobaqepsive etj.

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

Kapitali i Shoqerise

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë) Lekë.

1. Ortaku themelues Znj. Daniela Aliaj: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë leke) që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj Znj. Daniela Aliaj, i cili do te jete dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posaçme.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut.

Neni 8

Ortaku ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Ka te drejte te caktoje financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Kavaje.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "ITALFIL" SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakut.

Ortakut themelues:

Danieja Aliaj

